

*Më shumë se 400 studiues dhe praktikues nga më shumë se 30 shtete kontribuan në këtë udhëzues

Përfshirja e normave të reja

Praktika klinike është komplekse - duhet të presim që të shfaqen dilema etike.

A JANË NORMAT ETIKE PJESË E PRAKTIKËS NË VENDIN TIM TË PUNËS?

Dilemat etike nuk janë të kufizuara në një moment të caktuar kohor dhe mund të mos përshtaten mirë në rregulloret e etikës. Politikat dhe praktikat duhet ta pasqyrojnë këtë gjë.

Gjërat ndryshojnë teksa kontakti klinik shpaloset, gjë që kërkon vërejtje dhe vëmendje të vazhdueshme ndaj sfidave të reja etike. Parashikimi i sfidave na ndihmon të vërejmë se kur gjërat marrin një kthesë të papritur. Çdo dilemë me të cilën përballemi ka gjasa të jetë shumëfish e rëndësishme dhe mund të kërkojë bashkëpunim për të gjetur zgjidhjen më të mirë.

Mjekët klinikë inkurajohen të flasin kur përballen me sfida etike dhe të arrijnë dhe të kërkojnë mbështetje nga kolegët në fshatin klinik global. Ne duhet të presim raportimin e ndryshimeve dhe sfidave brenda kontaktit klinik dhe të mbështesim në mënyrë aktive gjetjen e zgjidhjeve.

Proceset e forta të etikës duhet të kenë një komponent rregullator dhe mbështetës. Përgjegjësia për kontekste komplekse duhet të përfshijë:

- Mbikëqyrje të rregullt klinike dhe mbikëqyrje nga homologët
- Një proces për raportimin dhe ndarjen e sfidave të hasura dhe zgjidhjeve të arritura (si për rritjen e përgjegjshmërisë ashtu edhe për të promovuar një kulturë të të mësuarit)



KONTAKTO AUTORËT

EMAIL:
ethicalglobalresearch@ed.ac.uk

Dr. Clara Calia, Prof Liz Grant, Prof Corinne Reid, The University of Edinburgh, United Kingdom

Dr. Cristobal Guerra, Universidad Santo Tomás, Chile

www.ethical-global-research.ed.ac.uk



Përfshirja e zgjidhjeve etike në situata klinike komplekse

Zgjidhet etike janë:

- të dizajnuara për të rritur sigurinë dhe mirëqenien e klientëve tanë,
- të dizajnuara për të ruajtur sigurinë dhe mirëqenien e mjekëve klinikë të përgjegjshëm kontekstualisht
- të dizajnuara për të inkurajuar barazinë sociale dhe komunitete të zhvilluara dhe të qëndrueshme
- prezentë në shumë vende
- të ndërtuara mbi vlerat e përbashkëta humanitare dhe komunitare
- të dizajnuara për të marrë parasysh të gjithë rrugëtimin klinik, duke përfshirë efektet e trashëguara
- në përputhje me parimet thelbësore dhe rregulloret përkatëse
- mundësuar përmes bashkëpunimit, praktikës reflektuese dhe të qënurit të hapur ndaj inovacionit
- të ndërgjegjshme për ndikimin e ndryshimeve të fuqisë në axhendat, proceset dhe raportimin klinikë
- të mbështetura nga proceset institucionale dhe mbështetja e vazhdueshme
- mund të kërkojë që ne (klientët dhe partnerët tanë të shërbimit) të jemi të përgatitur për të “marrë rrugën e gjatë”.

Vendimmarrja etike në një mjedis kompleks klinik nuk është:

- thjesht adoptimi dhe ndjekja e një procesi të standardizuar ose një procedure të pandryshueshme
- një veprim që kryhet “një herë”
- e nxitur kryesisht nga vendimet e financimit ose axhendat politike të kryera të izoluara nga klientët tanë ose nga komunitetet - ndërhyrja klinike nuk duhet të imponohet.



We are grateful for
Wellcome ITPA funding



THE UNIVERSITY
of EDINBURGH



Një udhëzues për profesionistët e kujdesit shëndetësor që punojnë në mjedise komplekse

Një rrugëtim klinik etik

Praktika klinike në kontekste komplekse paraqet sfida të veçanta. Praktika më e mirë në një mjedis mund të mos përshtatet në një tjetër. Kjo mund të çojë në dilema etike gjatë gjithë rrugëtimin klinik.

Në kontekstet ndërkulturore, angazhimi dhe besimi në shërbimet shëndetësore dhe të shëndetit mendor ndikohet nga: të kuptuarit e nevojave kulturore, ndërhyrjet kulturore përkatëse dhe disponueshmëria e personelit me përkatësi të ndryshme etnike.

Qëllimi i këtij udhëzuesi ndihmues është të:

- Kontribuojë në lëvizjen globale për praktikën e dekolonizuar etike ndërmjet partnerëve globalë në kujdesin shëndetësor; dhe
- Të përmirësojë qasjen në mjete për të mbështetur praktikën në sistemet kombëtare shëndetësore, OJQ-të dhe në praktikën private

Çfarë do të mundësojë një veprim etik të qëndrueshëm në praktikën klinike?

Etika e praktikës klinike ka të bëjë me vendimmarrjen dhe veprimin e përditshëm në të gjitha aspektet e shërbimeve klinike dhe në veçanti gjatë kontaktit me klientin.

Për të na ndihmuar të identifikojmë dhe adresojmë sfidat etike, ne kemi hartuar një rrjet ndikimesh që formojnë fije të ndërvarura që gërshetohen në të gjitha fazat e rrugëtimin të praktikës klinike:

- Vendi:** aspektet fizike, politike, kulturore dhe historike të vendit
- Njerëzit:** klientët, praktikuesit, kolegët, hisedarët e komunitetit
- Parimet:** rregulloret etike dhe ligjore që duhet të udhëheqin praktikën
- Precedentët:** praktikatat e kaluara - të suksesshme dhe jo të suksesshme.

Reflektimi për secilën prej këtyre 4 pikave mund të sqarojë sfidat etike si dhe të na ndihmojë të gjejmë zgjidhjet e mundshme

Puna klinike ndikon në jetë. Praktika etike globale ka dhembshuri, është e adaptueshme dhe e përgjegjshme në mënyrë të barabartë.

Sfidat etike nuk janë gjithmonë të dukshme dhe gjetja e zgjidhjeve mund të jetë sfiduese. Partneritetet mund të forcohen kur kjo punë ndërmerret së bashku.

Shpesh herë ka më shumë se një zgjidhje etike për të njëjtin problem. Ndonjëherë bëhet fjalë për zgjedhjen e “opsionit më etik, megjithëse është e papërsosur, tani për tani”.

Sfidat, së bashku me zgjidhjet, ekzistojnë në një ndërveprim dinamik – ajo që funksionon këtë herë mund të mos funksionojë herën tjetër – zgjidhjet tona duhet t'i përgjigjen rrethanave në zhvillim.

Të qënurit të hapur ndaj ideve të reja mund të nxisë inovacionin në momente të papritura. Shpesh, zgjidhjet krijuar mund të jenë zgjidhje etike.

BRENDA: Infografiku
KOPERTINA E PASME:

Përfshirja e normave të reja në praktikën dhe institucionet tona

NJË RRUGËTIM KLINIK ETIK

Forcimi i mënyrës se si punojmë në mjedise komplekse dhe të brishta për të mundur veprime dhe rezultate etike.

Konsideratat etike janë të rëndësishme në çdo fazë të një rrugëtimi klinik.

Rrugëtimi i praktikës klinike është i gjatë dhe shpesh i mundimshëm në kontekste komplekse. Sfidat etike mund të shfaqen në çdo fazë, që nga referimi deri te trashëgimia që mbetet shumë kohë pasi kontakti klinik është përfunduar.

SI MUND TË KONTRIBUOJ NË NJË VEPRIM ETIK? CILI ËSHTË PLANI IM?

Ky mjet është krijuar për të mbështetur reflektimin mbi sfidat etike me të cilat mund të përballemi në çdo fazë. Vini re se udhëtimi i praktikës klinike nuk është as linear dhe as i parashikueshëm. Rendi i fazave mund të jetë i ndryshëm. Shpesh kërkohet rishikimi i fazave të mëparshme

Katër pikat

Fijet e ndërlidhura

Aty ku shfaqen sfidat dhe dilemat etike. Aty ku mund të gjenden zgjidhje.

Këto fije të ndërlidhura kalojnë nëpër të gjitha fazat e marrëdhënies klinike. Për të kuptuar dilemat dhe për të gjetur zgjidhje etike, ne duhet të reflektojmë mbi këto fije në mënyra shumëdimensionale.

VENDI

Çfarë do të funksionojë në këtë kontekst?

NJERËZIT

Kush do të na ndihmojë të sjellim më të mirën tonë dhe të tërheqim mbështetjen që na nevojitet?

PARIMET

Çfarë botëkuptimi dhe vlerash do të na udhëheqin më së miri?

PRECEDENTËT

Çfarë duhet të ndjekim apo të sfidojmë në mënyrat e vendosura të punës?

Kultura e ambientit klinik

Secili prej nesh është i formuar nga një botëkuptim i veçantë në institucionin/komunitetin ku jemi të vendosur, si dhe institucionin në të cilin jemi trajnuar.

Në çfarë mënyrash kultura profesionale e këtij shërbimi klinik mund të krijojë mundësi ndihmëse ose tensione jo të dobishme për kryerjen e suksesshme të këtij shërbimi ?

Monitorimi dhe përshtatja

Provat që mbledhim sigurojnë një domosdoshmëri etike për të riafirmuar ose rishikuar formulimin e rastit tonë, dhe nga ana tjetër, rrugën tonë klinike

A kemi treguar përkushtim ndaj praktikës reflektuese, rishikimit dhe riformulimit me këtë klient? Si të zgjedhim mjetet e vlefshme?

Krijimi i një mjedisi terapeutik

Një mjedis terapeutik është çelësi për rezultate të forta dhe pozitive klinike. Ai krijon një bazë etike për angazhimin klinik bashkëpunues gjatë kohërave të shqetësimit dhe cënueshmërisë.

A po i japim përparësi një klime besimi dhe jogjykses për punën tonë klinike?

Përfundimi i ndërhyrjes së planifikuar dhe të paplanifikuar

Angazhimi pozitiv me përfundimet, sido që të ndodhin, mund të jetë një kontribut i rëndësishëm në rezultatet terapeutike

Si mund të sigurohemi që përfundimi i kontaktit klinik të jetë një përvojë afirmuese dhe forcuese?

Ruajtja e Marrëdhënieve me Klientin(ët)

Pritja e luhatjeve në këtë marrëdhënie na mundëson t'i trajtojmë ato hapur kur ato ndodhin.

A po zhvillohet marrëdhënia jonë me klientin në mënyra pozitive në përgjigje të punës së përbashkët që po ndërmerret?

Terapia / Ndërhyrja

Ndërhyrja më e fortë do të pasqyrojë nevojat e këtij klienti të veçantë në këtë kontekst të veçantë.

Në çfarë mënyrash mund të ndikojë sfondi kulturor i klientit dhe mjekëve një ndërhyrje terapeutike të jetë e suksesshme?

Formulimi i rastit

Të qenit i hapur për të dëgjuar historinë e klientit është çelësi për të siguruar që vlerësimi ynë të jetë gjithëpërfshirës, kontekstual dhe i mirëorientuar.

Në çfarë mënyrash ky proces vlerësimi mund të çojë në formime të pasakta?

Krijimi i një marrëdhënieje terapeutike

Puna klinike e suksesshme përfshin partneritet të respektueshëm midis klientit dhe ekipit të shërbimit klinik.

Si mund të krijojmë një marrëdhënie terapeutike me klientin ku ka dallime kulturore?

Efektet e trashëgimisë së ndërhyrjes

Ne gjithmonë duhet të marrim parasysh ndikimin afatgjatë të çdo kontakti klinik – si për klientin ashtu edhe për mjekun klinik

Cilat janë hapat kritikë për të siguruar që ndërhyrjet klinike mund të përkthehen me sukses në jetën e klientëve tanë?

Parimet dhe vlerat udhëzuese

Një busull për të udhëhequr veprimet etike - veçanërisht në situata komplekse klinike.

MOS BËNI DËM

Dëmi mund të ndodhë përmes veprimit dhe mosveprimit klinik. Kuptoni rëndësinë dhe implikimet etike të zgjedhjeve klinike. Veproni për të parandaluar dëmin.

MUNDËSONI ZHVILLIMIN

Mundësoni ndryshimet e nevojshme dhe urgjentisht të nevojshme për të mbështetur klientët tanë që të jenë vetvetja e tyre më e mirë dhe të angazhohen pozitivisht me botën e tyre. Bëhuni një aktivist për rëndësinë e shëndetit mendor dhe mirëqenies për komunitetet e forta.

LIDHNI : NJERËZIT DHE PLANETIN NË FILLIM

Investoni në marrëdhënie - kuptoni se ato janë zemra e praktikës klinike - dëgjoni me kujdes, jini të besueshëm, transparent dhe të përgjegjshëm dhe silluni me nder

JINI VIGJILENT JINI GUXIMTAR KINI KUJDES

Jini në gjendje të identifikoni dhe t'u përgjigjeni me vigjilencë sfidave etike, duke qenë vigjilent ndaj konsideratave të sigurisë për klientin, mjekun dhe komunitetin

INVESTONI NË TË MËSUARIT TONË

Jini të vetëdijshëm dhe aktivisht përforconi aftësitë ndërpersonale dhe praktikën reflektive

KONTEKSTI DHE DHEMBSHURIA

Punoni gjithmonë në një mënyrë të përgjegjshme dhe të dhembshur nga ana kontekstuale

ANGAZHIM

Jini reflektues, të përgjegjshëm dhe këmbëngulës kur përballeni me sfida etike